



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 28.03.2023

Nr: 34

Ora: 12:30

VENDIM

**PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS SË KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE NR.
11, DATË 25.03.2023**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 28.03.2023, me pjesëmarrjen e:

Ledio BRAHO	-	Relator
Elvin LAKO	-	Anëtar
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan RUSMALI	-	Anëtar
Koli BELE	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: **Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

OBJEKT: Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj z. Armando Subashi, Kryetar në Bashkinë Fier; z. Nuri Belba, Kryetar në Bashkinë Prrenjas; z. Kastriot Gurra, Kryetar në Bashkinë Librazhd; personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit; personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në

Bashkinë Poliçan; personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Bashkinë Skrapar; personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Bashkinë Roskovec; personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Bashkinë Lezhë; personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Bashkinë Bulqizë; personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Bashkinë Elbasan.

BAZË LIGJORE:

Nenet 21/dh, 129, dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 17, neni 34, shkronja “b” dhe neni 35 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka depozituar pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve kërkesën për vënie sanksioni ndaj personave përgjegjës të dhjetë institucioneve publike, e cila është regjistruar në regjistrin e kërkesave për masat disiplinore, me nr. 11 regj., datë 25.03.2023. Në mbledhjen e datës 28.03.2023, ora 12:30, pas relatimit të anëtarit Ledio Braho, u konstatua se kërkesa i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 35, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” dhe në mbështetje të nenit 45, pika 1, shkronja “c”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 129, pika 3, shkronja “a”, 130 dhe 131 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve,

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës nr. 11, datë 25.03.2023 të paraqitur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve;
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 29.03.2023 ora 12:30;
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Vendimi është i formës së prerë dhe nuk mund të bëhet ankim.

Ledio BRAHO - **Relator**

Elvin LAKO - **Anëtar**

Elvis ÇEFA - **Anëtar**

Ilirjan RUSMALI - **Anëtar**

Koli BELE - **Anëtar**